



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR PËRCAKTIMIN E RENDITJES SË
SUBJEKTEVE ZGJEDHORE NË FLETËN E VOTIMIT PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 30.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a" dhe neni 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, udhëzimi i KQZ-së nr. 3, datë 04.03.2015. "Për procedurën e hedhjes së shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore ne fletën e votimit"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmeve,

VËREN

Në mbështetje të nenit 98 të Kodit Zgjedhor, renditja e subjekteve në fletën e votimit përcaktohet më short. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përcaktuar rregullat për procedurën e

Nr.728 i Vendimit Data 30.05.2019 Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.



shortit me udhëzimin nr. 3, datë 04.03.2015 "Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit".

Sipas udhëzimit të sipërcituar, në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore shorti organizohet duke përfshirë në short të gjitha partitë politike që kandidojnë më vete, koalicionet zgjedhore dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit që janë regjistruar si të tillë në të gjitha zonat zgjedhore. Pas përcaktimit të renditjes në fletën e votimit të partive politike që kandidojnë më vete, koalicioneve zgjedhore dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, KQZ me short përcakton renditjen e partive politike, pjesëtare në koalicionin zgjedhor, brenda hapësirës që i përket koalicionit zgjedhor në fletën e votimit.

Në përfundim të afatit për regjistrimin e kandidatëve për kryetar dhe listave shumemërore të kandidatëve për këshillat, janë regjistruar gjithësej dy koalicione zgjedhore, Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASE) me 21 (njëzet e një) parti pjesëtare dhe Shpresa për Ndryshim (SHN) me 6 (gjashtë) parti politike pjesëtare, 9 (nëntë) parti politike që garojnë më vete, dhe 2 (dy) kandidat të mbështetur nga zgjedhësit për Bashkinë Himarë dhe 3 (tre) kandidat për Bashkinë Finiq.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 98 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, udhëzimi i KQZ-së nr. 3, datë 04.03.2015. "Për procedurën e hedhjes së shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit

V E N D O S I

1. Të miratojë rezultatin e shortit duke përcaktuar numrin rendor që do të ketë çdo subjekt zgjedhor në fletën e votimit, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

Nr.728 i Vendimit Data 30.05.2019 Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

